




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 20/DPK	Nr. Prot. 01-3666/15
Dep. 03	Pro. No. 28.10.2015
Nr. Titull	Data
Proj. Strategjia	Datum
Nr. pages	Datë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

DATË/A:	27/10/2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-DPKPP – 03-03/3526/15
PËR/ZA/TO:	z. Alajdin IBRAHIMI Zyrtar i Prokurimit – Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
CC:	z. Ramadan GASHI Drejtor Ekzekutiv – Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin: “Punimi dhe Xhirimi i Spotit Televiziv për ANJF”

**I nderuar z. IBRAHIMI,**

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: “Punimi dhe xhirimi i Spotit Televiziv për ANJF” me numër prokurimi: ANJF/15/017/236, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

**OPINION**

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin: “Punimi dhe xhirimi i Spotit Televiziv për ANJF” me numër prokurimi: ANJF/15/017/236, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.



## A r s y e t i m

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, përmes zyrës së prokurimit ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull: “Punimi dhe xhirimi i Spotit Televiziv për ANJF” me numër prokurimi: ANJF/15/017/236 i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së më datë: 21/10/2015 në Procedurën e Hapur. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurim Publik, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar dhe trajtuar këtë procedurë të prokurimit. Gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi, Agjencia Kundër Korrupsion ka hasur në disa dhëna të cilat nuk janë në pajtim me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik.

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 21/10/2015 tek rubrika IV.2. KRITERET E DHËNIES si kriter për dhënien e kontratës është caktuar “Çmimi ekonomikisht më i favorshëm”, por nuk janë dhënë nën kriteret sipas të cilave mund të vlerësohet tenderi më i favorshëm ekonomikisht. Në Dosjen e Tenderit, tek Aneksi 4. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS, janë paraqitur në formë tabelore 5 nën kriteret me të cilat mund të vlerësohet se cili është ofertuesi më i favorshëm për Autoritetin Kontraktues. Në tabelë janë paraqitur të njëjtat kriteret që paraprakisht ishin kërkuar tek Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME. Autoriteti kontraktues duhet të bëjë një dallim të qartë në mes kriterëve të përzgjedhjes dhe kriterëve për dhënie të kontratës, sipas ligjit të prokurimit publik kriteret e përzgjedhjes nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë si kriteret për dhënie të kontratës. Autoriteti kontraktues duhet të sigurohet që nuk ka përsëritje të këtyre dy kategorive të kriterëve në Dosjen e Tenderit.

Po ashtu Autoriteti Kontraktues në “Njoftim për Kontratë” nuk ka paraqitur informatat e duhura sa i përket specifikimeve teknike të detyrueshme dhe kriterëve që janë caktuar për dhënien e kontratës. Nëse autoriteti kontraktues ka specifikuar se kontrata publike do t'i shpërblehet operatorit ekonomik që ka paraqitur tenderin ekonomikisht më të favorshëm, autoriteti në fjalë duhet të specifikojë në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit kriteret që do të merren parasysh gjatë vendosjes së fituesit dhe peshën që i është dhënë secilit kriter. Pra, sa më shumë që është e mundshme, autoriteti kontraktues duhet të specifikojë çdo kriter në mënyrë objektive dhe kuantitative si dhe duhet të shprehë peshën që i është dhënë atyre. Në rastin e këtij aktiviteti të prokurimit, Autoriteti Kontraktues nuk e ka bërë një gjë të tillë. Agjencia ka vërejtur gjithashtu se “Njësia e Kërkesës” i ka propozuar edhe kriteret e përzgjedhjes e që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Në udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik, përcaktohen qartë funksionet e njësisë kërkuese dhe njësisë së prokurimit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 27 Dosja e Tenderit; nenin 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes nenin 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës të Ligjit të Prokurimit Publik 04/L-042; Pikat 9 dhe Pika 23 nga Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, gjegjësisht Funkcionet e Njesisë së Kërkesës dhe Kriteret e përzgjedhjes.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

